



KONKURS PËR APLIKIMIN E STUDENTËVE PËR PJESËMARRJE NË

KLINIKËN LIGJORE E DREJTA NDËRKOMBËTARE - REFUGJATËT DHE PERSONAT PA SHTETËSI

Fakulteti Juridik, Universiteti i Prishtinës në bashkëpunim me UNHCR-në dhe Programin për të Drejtat Civile në Kosovë, organizon klinikën ligjore për mbrojtjen ndërkombëtare-refugjatët dhe personat pa shtetësi. Klinika ligjore organizohet në kuadër të marrëveshjes në mes të Fakultetit Juridik dhe UNHCR-së.

Ftohen të gjithë studentët e vitit të tretë dhe të katërt akademik të aplikojnë për pjesëmarrje në Klinikë:

Kushtet për aplikim:

1. Student aktiv në vitin e III apo të IV akademik, në Fakultetin Juridik;
2. Nota mesatare mbi 8 (tetë);
3. Preferohet njohja e gjuhës angleze;

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

1. CV;
2. Dëshmi për statusin e studentit të rregullt;
3. Certifikata e notave.

Aplikimi bëhet online në emailin: legalclinics@uni-pr.edu deri me datën 12 Tetor 2022, në ora 16:00.

Gjatë përzgjedhjes parimi i barazisë gjinore do të merret parasysh.

Studentët e përzgjedhur do të njoftohen më së largu deri më 17 Tetor 2022.

Klinika do të filloj punën më datën 18 Tetor 2022 në ora 14:00, në Gjykatoren e Fakultetit Juridik.

Në mbarim të klinikës, pjesëmarrësit do të pajisen me çertifikatë për pjesëmarrje të suksesshme.